

L I G J
Nr.8462 datë 10.3.1999

**PËR RATIFIKIMIN E DY PROTOKOLLMARRËVESHJEVE DHE TË SHITESËS SË
PROTOKOLLMARRËVESHJES, LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË
USHTRISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e “Protokollmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Republikës të Turqisë, për riparimin e ndërtesave të Akademisë së Forcave të Mbrojtjes Detare, pajisjen me mjete mësimore dhe stërvitore të saj, mbështetjen me elemente këshillimore në fushën administrative dhe atë të planprogrameve mësimore dhe për mbështetjen me personel, stërvitorë dhe këshilltarë, në fushën e programeve të stërvitjes së Forcave të Mbrojtjes Detare të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Ratifikimin e “Protokollmarrëveshjes dhe të shtesës së saj ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës të Shqipërisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Republikës të Turqisë, për riparimin dhe mirëmbajtjen e kantierit të Pashait dhe të ndërtesave të ushtarëve, për mbështetje këshillimore dhe me instruktorë teknikë të instalimeve të pajisjeve të oficinës, për ta rikthyer në gjendje pune dhe për menaxhimin e hapësirës së Dokut”.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2337, datë 19.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

PROTOKOLL

MIDIS SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE MINISTRISË
SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RIPARIMIN E NDËRTESAVE TË
AKADEMISË SË FORCAVE DETARE, PAJISJEN ME MJETE MËSIMORE DHE
STËRVITORE TË SAJ, MBËSHTETJEN ME ELEMENTE KËSHILLIMORE NË FUSHËN

ADMINISTRATIVE DHE ATË TË PLANPROGRAMEVE MËSIMORE DHE PËR
MBËSHTETJEN ME PERSONEL STËRVITOR DHE KËSHILLTAR NË FUSHËN E
PROGRAMEVE TË STËRVITJES SË FORCAVE TË MBROJTJES DETARE TË
SHQIPËRISË

Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë (kështu do të emërtohen palët në këtë protokoll) bazuar në:

“Marrëveshjen e bashkëpunimit shkencor, teknik dhe mësimor në fushën ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, të datës 29 korrik 1992.

“Marrëveshjen e bashkëpunimit teknik në fushën e industrisë ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, të datës 19 nëntor 1992.

“Marrëveshjen e bashkëpunimit mësimor në fushën ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, të datës 19 nëntor 1992 dhe

“Protokollin e bashkëpunimit dhe të ndihmës midis Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Shqipërisë”, të datës 27 qershor 1997.

Për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe miqësisë që ekziston midis dy vendeve në fushën ushtarake (riparimi i ndërtesave të Akademisë së Forcave Detare, pajisja me mjete mësimore e stërvitore të saj, mbështetja me elemente këshillimore në fushën administrative dhe atë të plan programeve mësimore dhe për mbështetjen me personel stërvitor dhe këshilltar në fushën e programeve të stërvitjes së Forcave të Mbrojtjes Detare të Shqipërisë dhe për të kontribuar në stabilitetin e Ballkanit palët bien dakord që:

KAPITULLI I
QËLLIMI

Është përcaktimi i statusit reciprok dhe i veprimeve në lidhje me parimet e përgjithshme të marrëveshjes për riparimin e ndërtesave të Akademisë së Forcave Detare në qytetin e Vlorës së Republikës të Shqipërisë, pajisjen me mjete mësimore e stërvitore të saj, mbështetjen me elemente këshillimore në fushën administrative dhe atë të plan-programeve mësimore dhe për mbështetjen me personel stërvitor dhe këshilltar në fushën e programeve të stërvitjes së Forcave të Mbrojtjes Detare.

KAPITULLI II
PËRMBAJTJA

Ky protokoll përfshin komandat e Forcave Detare të Turqisë dhe të Shqipërisë, personelin e ngarkuar për arritjen e protokollit, mjetet e pajisjet në lidhje me këtë protokoll dhe probleme të tjera të domosdoshme për të realizuar qëllimin e protokollit.

KAPITULLI III
PËRKUFIZIME

Në këtë projektprotokoll janë përmendur termat e mëposhtme:

a. Vendi dërgues:

Përfaqëson personelin e vendit të huaj në shtetin tjetër për zbatimin e protokollit të ndihmës dhe të bashkëpunimit.

b. Vendi pritës:

Është vendi në të cilin janë përqendruar forcat e vendit dërgues për bashkëpunim dhe mbështetje.

c. Protokoll i bashkëpunimit dhe i ndihmës:

Është “Protokoll i bashkëpunimit dhe i ndihmës midis Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për të siguruar bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve dhe për të bërë koordinimin e ndihmave që vijnë nga vendi dërgues në vendin pritës”, i nënshkruar më 27 qershor 1997.

d. Ndihma:

Është mbështetja e dërguar nga vendi dërgues në vendin pritës për ndërtimin dhe riparimin e ndërtesave, mbështetja në stërvitje, ndihma në pajisje dhe mjete mësimore dhe kredi apo shërbime të tjera teknike në lidhje me këtë temë:

e. Riparimi dhe mirëmbajtja e ndërtesës:

Është modifikimi, riparimi dhe mirëmbajtja e të gjitha ndërtesave të Akademisë së Forcave Detare në qytetin e Vlorës.

f. Mjetet dhe pajisjet mësimore

Është e gjithë baza materiale mësimore e përcaktuar si e domosdoshme nga ana e Komandës së Forcave Detare Turke për Akademinë e Forcave Detare të Shqipërisë.

g. Personel teknik, këshillimor, drejtues dhe stërvitor.

Është personeli teknik, administrativ, këshilltarët për programet mësimore e stërvitore të ngarkuara përkohësisht nga vendi dërgues në vendin pritës për riparimin e ndërtesave të Akademisë së Forcave Detare të Shqipërisë dhe për plotësimin e nevojave në drejtim të stërvitjes dhe procesit mësimor në këtë akademi dhe në Qendrën Stërvitore të këtyre Forcave.

h. Personel ndërlidhës i ngarkuar nga Shqipëria.

Është një person ose më tepër njohës i gjuhës turke, i ngarkuar nga ana e Shqipërisë në Vlorë dhe/ose në Tiranë për të siguruar koordinimin midis përfaqësuesve të Shqipërisë dhe personelit të ngarkuar përkohësisht nga Turqia për të realizuar veprimtaritë e përcaktuara në këtë protokoll.

i. Firma e ngarkuar me punime

Është firma ndërtuese e ngarkuar nga Turqia për të bërë riparimin e ndërtesave të Akademisë së Forcave Detare në Vlorë.

KAPITULLI IV PARIME TË PËRGJITHSHME

a. Sigurimi i nevojave për punë dhe për strehim (fjetje) të personelit të ngarkuar përkohësisht nga Turqia, në Akademinë e Forcave Detare në Vlorë do të bëhet nga ana e autoriteteve shqiptare.

b. Sasia e personelit teknik që do të dërgohet për riparimin e ndërtesave, e personelit këshillimor, administrativ dhe e personelit stërvitor si dhe koha e qëndrimit të tyre në Shqipëri do të përcaktohen nga ana e Turqisë në lidhje me nevojat që paraqiten.

c. Personeli turk i ngarkuar për realizimin e këtij protokoll do të vendoset në një ndërtesë të caktuar nga pala shqiptare në Vlorë. Ruajtjen e jashtme të kësaj ndërtese dhe problemet e ndryshme administrative që mund të dalin në lidhje me këtë ndërtesë, do të sigurohen nga pala shqiptare.

d. Të gjitha materialet dhe pajisjet e sjella nga firma ndërtuese për riparimin e ndërtesave të Akademisë së Forcave Detare si dhe materialet mësimore dhe materiale të tjera të domosdoshme të sjella nga Turqia në lidhje me strukturën e këtyre punimeve, do të përjashtohen nga taksat doganore dhe nga çdo lloj takse tjetër gjatë ushtrimit të veprimtarisë ndërtimore dhe përdorimit të tyre.

e. Për dërgimin e materialeve nga Turqia në bazën e Pashalimanit dhe në Vlorë do të përdoren porti i Durrësit dhe aeroporti i Rinasit. Në këtë drejtim, nga ana e Shqipërisë do të

sigurohen të gjitha lehtësirat e nevojshme portuale dhe aeroportuale.

f. Nga ana e Forcave të Armatosura të Shqipërisë do të merren të gjitha masat për ruajtjen e materialeve dhe pajisjeve gjatë transportimit brenda territorit të Shqipërisë dhe gjatë përdorimit të tyre në vend. Për ruajtjen e personelit turk në rajonin e Vlorës dhe sigurimin e punës normale, nga ana e Turqisë mund të caktohet një repart ruajtjeje. Natyra dhe madhësia e këtij reparti do të përcaktohet me marrëveshje të të dy palëve.

g. Shqipëria pranon që personeli i firmës ndërtuese i caktuar nga Turqia për riparimin e ndërtesave të Akademisë të Forcave Detare në Vlorë dhe personeli tjetër që punon për realizimin e protokollit përfaqëson Turqinë. I gjithë dokumentacioni për pajisjet e materialet që do të përdoren gjatë riparimeve e ndërtimeve dhe i bazës materiale për mësim e stërvitje do t'u njoftohet autoriteteve shqiptare nëpërmjet grupit të koordinimit dhe bashkëpunimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në Tiranë.

h. Për veprimtaritë që përcakton ky protokoll, pala shqiptare do të caktojë personel të posaçëm.

KAPITULLI V

TEMA E PROTOKOLLIT, FUSHA E BASHKËPUNIMIT DHE E NDIHMËS

a. Palët kanë rënë dakord që bashkëpunimi dhe ndihma do të jetë sipas planit të detajuar që do të përgatitet nga Forcat Detare të Republikës së Turqisë veçanërisht në:

(1) Për Akademinë e Forcave Detare në Vlorë

(a) Riparimi i ndërtesave

(b) Sigurimi dhe mbështetja me mjetet e pajisjet e domosdoshme në fushën e procesit mësimor.

(c) Ripunimi i programeve mësimore. Dërgimi i personelit mësimdhënës e mësimor nga vendi dërgues.

(d) Dërgimi i personelit këshillimor dhe drejtues nga Turqia (oficerë për planizimin e stërvitjes, kujdestar për studentët, komandant grupesh mësimore etj.)

(f) Zbatimi dhe kryerja e studimeve në fushën e riorganizimit sipas nevojave të përcaktuara nga palët.

(g) Hartimi i planeve të përbashkëta për përgatitjen e personelit mësimdhënës dhe të personelit tjetër sipas nevojave të përcaktuara nga pala shqiptare.

(h) Bashkëpunimi për përkthimin e leksioneve dhe referateve të ndryshme në shqip dhe ngritja e grupeve të përbashkëta sipas nevojave. Kryerja e veprimtarisë së tyre në Shqipëri ose në Turqi.

(2) Për përgatitjen e ushtarëve

(a) Hartimi i një protokollit të veçantë që përmban projektet për pajisjen e reparteve të uzinës së riparimit të anijeve në Pashaliman dhe për riparimin e ndërtesës së ushtarëve në këtë bazë.

(b) Përgatitja e programeve stërvitore për ushtarët e Forcave Detare të Shqipërisë.

(c) Zhvillimi i stërvitjes me ushtarët detarë shqiptarë nga personel i specializuar turk.

B. Probleme të përbashkëta

Shkëmbimi reciprok i personelit për bashkëpunim, studime të ndryshme, koordinim në fushën e arsimit dhe të stërvitjes sipas nevojave të përcaktuara në protokoll.

KAPITULLI VI

PROBLEME TË TJERA

A. Uniforma:

Do të jetë në fuqi "Marrëveshja e bashkëpunimit shkencor teknik dhe arsimor në fushën

ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë” të nënshkruar më 29 korrik 1992.

B. Procedurat me pasaporta:

Do të jetë në fuqi “Marrëveshja e bashkëpunimit shkencor, teknik dhe arsimor në fushën ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, të nënshkruar më 29 korrik 1992. Gjithashtu, personeli turk që do të dërgohet në Shqipëri në bazë të këtij protokoll, do të pajiset me dokument identifikimi.

C. Probleme financiare:

Shpenzimet për ushqim dhe për qëndrim të personelit të dërguar nga vendi dërgues do të përballohen sipas dispozitave ligjore të vendit dërgues.

D. Lëvizja dhe transporti:

Të gjitha automjetet do të zbatojnë rregullat e vendit pritës.

E. Proceset gjyqësore:

Do të jetë në fuqi “Marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e arsimit ushtarak midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë” e nënshkruar më 19 nëntor 1992.

F. Disiplina:

Do të jetë në fuqi “Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e arsimit ushtarak midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

G. Dëmet, shkatërrimet dhe kompensimet:

Do të jetë në fuqi “Marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e arsimit ushtarak midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”.

H. Çështjet e tjera që nuk zënë vend në këtë protokoll do të jenë siç janë përcaktuar në “Marrëveshjen e bashkëpunimit shkencor teknik dhe arsimor në fushën ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, e nënshkruar më 29 korrik 1992.

KAPITULLI VII

SUGJERIME

Çdo njëra nga palët mund të propozojë të plotësojë protokollin ose ta modifikojë atë kur e sheh të arsyeshme. Në këtë gjendje nga data e lajmërimit për një gjë të tillë, brenda 30 ditëve duhet të fillojnë bisedimet. Dhe në rast se brenda 45 ditëve bisedime nuk merret asnjë përfundim, atëherë çdo njëra nga palët brenda 30 ditëve pasardhëse ka të drejtë të ndërpresë zbatimin e protokollit.

KAPITULLI VIII

FAZA E ZBATIMIT DHE E PËRFUNDIMIT

a. Faza e zbatimit të këtij protokoll është deri në përfundim të marrëveshjes së bashkëpunimit teknik, shkencor dhe arsimor në fushën ushtarake midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë. Në rast se do të ndërpritet zbatimi i marrëveshjes, edhe për këtë protokoll, nuk do të jetë e nevojshme asnjë procedurë tjetër por do të ndërpritet edhe zbatimi i këtij protokoll.

b. Pas miratimit të protokollit, në lidhje me planin e detajuar që do të përgatisë Turqia, Shqipëria do të bëjë përgatitjet e nevojshme dhe brenda dy muajve duhet të fillojë zbatimin e protokollit. Në lidhje me të gjithë veprimtarinë që përfshihet në këtë protokoll do të sigurohet bashkëpunimi i domosdoshëm.

c. Në rast se njëra nga palët nuk do të zbatojë këtë protokoll ose nuk do mund ta zbatojë, atëherë pala tjetër mund t'i dërgojë me shkrim pretendimet përkatëse. Nga koha e këtij

paralajmërimi me shkrim, brenda 30 ditëve duhet të fillojnë bisedimet. Në rast se brenda 45 ditëve bisedime nuk do të ketë ndonjë rezultat, atëherë në 30 ditët që vijojnë secila palë ka të drejtë të ndërpresë zbatimin e protokollit.

KAPITULLI IX MIRATIMI DHE HYRJA NË ZBATIM

Ky protokoll pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe shkëmbimit të notave, që tregojnë miratimin sipas metodave përkatëse ligjore, hyn në fuqi menjëherë.

KAPITULLI X KOPJET DHE NËNSHKRIMI

a. Ky protokoll për të qënë i zbatueshëm përgatitet në gjuhën shqipe, turke dhe angleze me nga dy kopje. Në rast se do të ketë paqartësira në njërin nga gjuhët do të merret si bazë gjuha angleze.

b. Ky protokoll është përgatitur në dy kopje më datë__1998 dhe është nënshkruar në ____.

PËRFAQËSUESI I MINISTRISË
SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
TURQISË

PËRFAQËSUESI I SHTABIT
TË PËRGJITHSHËM
TË REPUBLIKËS SË

Nënshkrimi
Emri: Kap.Rang.I Robert Bali
Titulli: Albanian CNO

Nënshkrimi
Emri. Adm Salim Dervisoglu
Titulli: Turkish CNO

PROTOKOLL

NDËRMJET SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE
MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË RRETH RIPARIMIT DHE
MIRËMBAJTJES TË KANTIERIT TË PORTIT TË PASHA-IT DHE NDËRTESAVE TË
BARAKAVE TË USHTARËVE, MBËSHTETJE KONSULTATIVE DHE ME INSTRUKTORE
TEKNIKË TË INSTALIMEVE TË PAJISJES SË OFIÇINËS, DUKE I VENDOSUR PËR
PUNË DHE MENIXHIMI I HAPËSIRËS SË DOKUT

Shtabi i Përgjithshëm i Republikës Turke dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë (që këtej e tutje referohen si palë).

Duke marrë në konsideratë kushtet në:

“Marrëveshjen rreth stërvitjes në Hapësirën Ushtarake dhe bashkëpunimi tekniko-shkencor ndërmjet Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, e nënshkruar më datën 2 korrik 1992

“Marrëveshjen rreth bashkëpunimit teknik dhe të industrisë së mbrojtjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, të nënshkruar më datë 19 nëntor 1992

“Marrëveshjen në bashkëpunimin dhe në stërvitjen ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”, të nënshkruar më datë 19 nëntor 1992

“Protokolli rreth Mbështetjes dhe Bashkëpunimit ndërmjet Shefave të Shtabeve të

Republikës së Shqipërisë dhe Turqisë”, i cili u nënshkrua më 27 qershor 1997.

Në hapësirën ushtarake (PORTIT TË PASHA-it DHE NDËRTESAVE TË BARAKAVE TË USHTARËVE. MBËSHTETJE KONSULTATIVE DHE ME INSTRUKTORË TEKNIKË TË INSTALIMEVE TË PAJISJES SË OFIÇINËS. DUKE I VENDOSUR PËR PUNË DHE MENIXHIMI I HAPËSIRËS SË DOKut.) për të forcuar bashkëpunimin dhe asistencën e gjithanshme, si dhe stabilizimin në vendet në Ballkan, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi

Riparimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave dhe barakave të ushtarëve dhe komandës së instalimit ushtarak, qendrës së kompresorëve, ofiçinave të anijeve, atyre të saldimit e të montimit, elektrike e të makinave, të motorave në Kantierin e Portit të Pasha-it dhe në ndërtesat e Komandës së Kantierit, si dhe instalimet e pajisjeve si dhe vënia në punë e këtyre ndërtesave. Përkufizimi i parimeve të përgjithshme rreth menixhimit të kantierit të personelit konsultativ e teknik dhe situatës së gjithanshme.

Neni 2

Përmbajtja

Ky Protokoll përfshin Komandën Detare Turke dhe atë Shqiptare, personelin e përfshirë në këtë subjekt protokoll, pajisjet rreth subjektit dhe subjekteve të tjera për vlefshmërinë e këtij protokollit.

Neni 3

Përkufizime

Përkufizimet në këtë protokoll përdoren për kuptimet e mëposhtme:

a. Dërguesi (Shteti)

Përkufizon shtetin i cili ka personel në vendin mik për aplikimin e kësaj mbështetjeje dhe protokollit të bashkëpunimit.

b. Pritësi (Shteti)

Përkufizon shtetin i cili mbështet dhe bashkëpunon me forcat e Shtetit dërgues.

c. Protokollit i mbështetjes dhe bashkëpunimi

Koordinimi i bashkëpunimit të dërguar nga Dërguesi (Shteti) tek pritësi (Shteti) dhe duke siguruar bashkëpunimin e gjithanshëm ushtarak ndërmjet palëve dhe protokollit i nënshkruar ndërmjet Shefave të Shtabit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë më datë 27 qershor 1997.

d. Mbështetja

Riparimi i ndërtesave, mbështetja e menixhimit, krediti ose shërbimi në subjekt, mbështetjen teknike tek shteti pritës nga shteti dërgues, si dhe riparimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave.

Ndërtimi i komandës së bazës, ndërtimi i komandës së kantierit, qendrës së kompresorëve, ofiçinave të montimit, elektrike, të motorave, saldimit, si dhe riparimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të barakave të ushtarëve, të cilat janë në Vlorë, kantierin detar të portit të Pasha-it.

f. Instalimi i ofiçinës dhe vendosja në punë e pajisjeve.

Pajisjet për t’u përcaktuar nga Flota Turke si kërkesa për qendrën e kompresorit, ofiçina e saldimit, montimit, elektrike, të motorave.

g. Personeli teknik dhe konsultativ

Personeli teknik dhe konsultativ të cilët ngarkohen nga shteti i dërgues në shtetin pritës

për riparimin dhe mirëmbajtjen e punishteve të kantierit shqiptar të portit të Pashait dhe ndërtesave të barakave të ushtarëve. Ato dërgohen sipas kërkesave të rëna dakord nga të dy palët.

h. Oficerët ndërlidhës të ngarkuar nga Shqipëria.

Për qëllim të koordinimit të veprimtarive të kufizuara me personel të përkohshëm nga Protokollit, të cilët dërgohen nga Turqia në mënyrë që të sigurojë koordinimin ndërmjet palëve, duke ngarkuar një ose më shumë persona që të flasin turqisht në Vlorë, Akademinë e Detarisë ose në Tiranë nga autoritetet shqiptare.

I. Kompanitë e ngarkuara

Kompanitë që Turqia bën një marrëveshje për riparimin dhe mirëmbajtjen e kantierit të Portit të Pashait e/ose në Vlorë dhe ndërtesat e barakave të ushtarëve, si dhe kompanitë që do të ndërmarrin instalimet dhe vendosjen në punë të fabrikave të kantierit.

Neni 4

Parime të përgjithshme

a. Ky protokoll i bindet palëve të protokollit.

b. Subjektet e kooperimit të parashikuara në këtë protokoll, do të përmbushen nga personeli i ngarkuar i palëve.

c. Akomodimi dhe situata e punës së personelit të ngarkuar përkohësisht rreth subjektit të Protokollit, nga Turqia në Vlorë. Kantieri i portit të Pashait do të sigurohet nga Shqipëria.

d. Kërkesat infrastrukturore (elektriku, uji, transporti etj.) në qytetin e Vlorës dhe në portin e Pashait do të rregullohen nga autoritetet shqiptare.

e. Numri dhe periudha e detyrës së personelit të Turqisë të ngarkuar nga Turqia për riparimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave, konsultuesit dhe personeli teknik të ngarkuar për menixhimin e kantierit do të përcaktohet nga Turqia në rast të kërkesave.

f. Personeli turk i ngarkuar për përmbajtjen e këtij protokollit do të akomodohet në një ndërtesë e cila do të caktohet nga autoritetet shqiptare në Vlorë. Janë të nevojshme masat e sigurimit në lidhje me këto ndërtesa dhe problemet administrative, të cilat duhen të merren parasysh dhe do të zgjidhen nga shqiptarët.

g. Pajisjet të cilat do të dërgohen nga Turqia për nevoja të kompanive turke të ngarkuara me subjekt riparim mirëmbajtjeje të kantierit të portit të Pashait dhe ndërtimit të banesave të ushtarëve në qytetin e Vlorës dhe gjithashtu në instalimin dhe vendosjen në punë të këtyre ndërtesave, do të përjashtohen nga çdo lloj takse doganore dhe takse tjetër.

h. Porti i Pashait dhe i Vlorës dhe nëse nevojitet porti i Durrësit dhe aeroporti i Rinasit do të përdoren për pajisjet e dërguara nga Turqia. Përveç këtyre kufijve, nëse nevojitet nga Turqia, Shqipëria do të sigurojë ndihmë për përdorimin e porteve dhe kufijve të tjerë.

i. Sigurimi i pajisjeve gjatë transportit në kufijtë e Shqipërisë në vendet ku ato duhet të përdoren është përgjegjësi e Forcave Ushtarake Shqiptare. Nëse bihet dakord nga të dy palët, një ekip/kompani ushtarësh mund të dërgohen në Vlorë për arsye sigurie.

j. Për qëllim të riparimit dhe mirëmbajtjes së kantierit të portit të Pashait dhe ndërtesave të barakave të ushtarëve, Shqipëria në emër të Turqisë, pret veprimtaritë e përfaqësuesve të kompanive të ngarkuara dhe personelin e tyre, që janë subjektet e tyre. Turqia pret për të deklaruar qysh më parë, për të dërguar dokumentet rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve dhe pajisjeve stërvitore dhe arsimore të autoriteteve shqiptare nga bashkëpunimi i Forcave Ushtarake Turke dhe Këshilli Koperues apo Tiranës.

k. Shqipëria ngarkon oficerët ndërlidhës për veprimtaritë e vendosura në këtë protokoll.

Neni 5

Subjektet e mbështetjes së protokollit dhe hapësira e bashkëpunimit

a. Palët kanë rënë dakord për të mbështetur dhe bashkëvepruar veçanërisht në hapësirat e

mëposhtme sipas planit të detajuar të veprimtarisë e cila do të përgatitet nga pala turke.

* Rreth kantierit shqiptar të portit të Pashait dhe ndërtesave të barakave të ushtarëve.

(1) Riparimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave.

(2) Për të siguruar mbështetje për pajisjet dhe materialet të cilat përcaktohen nga kërkesat në fushën e stërvitjes dhe të arsimimit.

(3) Koordinimi i veprimtarive të manixhimit të kantierit

(4) Personeli teknik dhe konsultativ i ngarkuar nga Turqia

(5) Anijet e Forcave Detare të Republikës së Turqisë, me qëllim vizitë, riparim, mirëmbajtje nga kantieri i Pashalimanit, në qoftë se do të ketë nevojë, do të bëhet një protokoll i veçantë në lidhje me këtë temë.

(6) Përbushja e veprimtarive të riorganizimit nëse nevojiten nga palët.

(7) Duke siguruar stërvitjen e detyrës tek personeli i caktuar në kantierin e portit të Pashait në Shqipëri dhe/ose në Turqi.

(8) Sigurimi i përkthimit të dokumenteve teknike dhe i teksteve të tjera të shkruara në shqip me kooperimin e palëve dhe formimin e grupeve të punës për të punuar në Turqi dhe në Shqipëri.

b. Parime të shumanshme

Dërgimi i gjithanshën dhe i përkohshëm i personelit me qëllim koordinimi, studimi dhe bashkëveprimi në fushat e mbështetjes manixhuese dhe teknike të protokollit në lidhje me nevojat.

Neni 6

Aspekte të tjera

A. Uniforma

Në protokoll gjithashtu do të aplikohen edhe dispozitat në “Marrëveshjen në bashkëpunimin teknik dhe shkencor, stërvitje në fushën ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë edhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”, datë 29 korrik 1992.

B. Pasaportat

Rregullat do të jenë të njëjtat me ato të përkufizuara në “Marrëveshjen në bashkëpunimin teknik dhe shkencor, stërvitje në fushën ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë edhe Qeverisë së Republikës të Turqisë,” datë 29 korrik 1992.

Personelit turk i cili do të caktohet në shtetin pritës, do t’i sigurohen karta identiteti të përkohshme nga shteti pritës.

C. Çështjet financiare

Ushqimi dhe akomodimet për personelin e shtetit dërgues do të sigurohen nga shteti dërgues.

D. Lëvizja dhe transporti

Brenda territorit të Shqipërisë, të gjitha mjetet do t’i binden rregullave të shtetit pritës dhe ligjeve përkatëse.

E. Juridiksioni

Dispozitat e Protokollit të datës 19 nëntor 1992 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë rreth Marrëveshjes së bashkëpunimit të stërvitjes ushtarake, do të aplikohen.

F. Disiplina

Dispozitat e Protokollit të datës 19 nëntor 1992 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë rreth marrëveshjes së bashkëpunimit të stërvitjes ushtarake, do të aplikohen.

G. Humbja dhe

Dispozitat e Protokollit të datës 19 nëntor 1992 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë rreth Marrëveshjes së bashkëpunimit të

stërvitjes ushtarke, do të aplikohen

h. Për të gjitha aspektet të papërmendura në këtë protokoll, do të zbatohet dispozitat e “Marrëveshjes në bashkëpunimin teknik dhe shkencor, stërvitje në fushën ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë edhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”, datë 29 korrik 1992.

Neni 7

Amendamenti dhe revizioni

Çdo palë mund të propozojë një amendament apo revizion tek kjo marrëveshje në çdo kohë me shkrim. Në këtë rast, palët do të fillojnë konsultimet brenda 30 ditëve, në mënyrë që të bindin këtë amendament ose revizion. Nëse s’ka rezultat bindës brenda 45 ditësh pas fillimit të konsultimeve, çdo palë mund të përfundojë këtë marrëveshje pas 30 ditësh pas një njoftimi me shkrim.

Neni 8

Zgjatja kohore dhe përfundimi

a. Ky protokoll është subjekt tek zgjidhja e “Marrëveshjes në bashkëpunimin teknik dhe shkencor, stërvitje në fushën ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”, datë 29 korrik 1992. Nëse kjo marrëveshje përfundon, protokollin bëhet automatikisht i pavlefshëm.

b. Pas nënshkrimit dhe miratimit të këtij protokollin, Shqipëria do të bëjë studime në planin e veprimtarisë që Turqia do të përgatisë dhe të përfundojë parapërgatitjet e saj si dhe ta vendosë në përdorim brenda 2 muajsh. Gjithashtu Shqipëria do të sigurojë bashkëpunimin për përmbajtjet e protokollit.

c. Nëse një prej palëve konkludon që pala tjetër nuk përmbush ose nuk mund të përmbushë protokollin, kjo palë do të propozojë konsulta me shkrim, të cilat do të fillojnë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Nëse brenda 45 ditëve nuk arrihet asnjë rezultat, çdo njëra prej palëve mund të përfundojë këtë protokoll 30 ditë pas datës së njoftimit me shkrim.

Neni 9

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje ka efekt pas nënshkrimit dhe në datën e shkëmbimit të notave duke e ratifikuar në lidhje me procedurat ligjore respektive.

Neni 10

Teksti dhe nënshkrimi

Ky agriment bëhet në dublikate, në..... (data) e Muajit të vitit dhe nënshkruhen në prezencë klauzolat e mësipërme në datë

Në emër të Republikës së Shqipërisë
Turqisë

Ministria e Mbrojtjes

Nënshkrimi

Emri: Kap.Rang.I Robert Bali

Në emër të Republikës së

Shtabi i Përgjithshëm

Nënshkrimi

Emri. Adm Salim Dervisoglu

SHTESË
E PROTOKOLLIT TË PUNIMEVE NË PASHALIMAN

Përpara fillimit të zbatimit të Marrëveshjes shqiptaro-Turke për vënien në efikasitet të Kantierit të Pashalimanit, palët kanë edhe këto detyrime reciproke:

I. Për vendosjen në gatishmëri pune të infrastrukturës mjediseve të jashtme)

a. Rrjeti elektrik:

Pala shqiptare duhet të sigurojë rrjetin 35 KVA, 6 KVA, 380 V dhe linjën elektrike prej transformatorëve të gabinave elektrike deri në objekte (reparte), si dhe ndriçimin e jashtëm. Pala turke, merr përsipër të realizojë punimet për furnizimin me energji elektrike brenda reparteve.

b. Sistemi i ujit të ëmbël:

Pala shqiptare duhet të bëjë riparimin e linjës ekzistuese nga Tragjasi deri në kantier si dhe brendapërbrenda kantierit. Pala turke, merr përsipër të sjellë dy elektropompa për këtë qëllim si dhe të bëjë montimin e tyre.

c. Sistemi i ajrit të presionit të ulët:

Pala shqiptare duhet të bëjë pastrimin dhe kolaudimin e dy bombulave të ajrit pas lokalit të kompresorëve dhe riparimin e sistemit të ajrit në kantier. Pala turke, merr përsipër të sjellë dy elektrokompresorë dhe të bëjë montimin e tyre. Po ashtu, ajo merr përsipër të sjellë edhe një pajisje për kontrollin dhe riparimin e sistemit të ajrit.

d. Sistemi i ujit të kripur dhe zjarrfikës:

Pala shqiptare, merr përsipër të punojë në vazhdimësi për të vënë në punë sistemin e ujit të kripur dhe atë zjarrfikës, sipas mundësive.

e. Rrugët dhe bankinat:

Pala shqiptare merr përsipër të bëjë riparimin e pjesshëm të rrugëve, si dhe të hapë rrugën për vendosjen e Dizel-Gjeneratorit në lokalin ekzistues. Po ashtu, ajo duhet të bëjë provat në peshëmbajtje të bankinës së nëndetësive me ngarkesë 50 ton.

f. Linjat telefonike

Pala shqiptare merr përsipër vendosjen e linjave telefonike brendapërbrenda kantierit dhe sigurimin e ndërlikdhjes së tij me Tiranën.

g. Sistemi i ujrave të zeza:

Pala shqiptare merr përsipër të riparojë sistemin e ujrave të zeza nëpër reparte dhe krijimin e mjediseve higjienike. Po ashtu, ajo do të sigurojë instalimin e sistemit të ujit të pijshëm në të gjitha repartet.

2. Vënia në efikasitet e reparteve

a. reparti i skafit:

Të kompletohen makina profilkthyes, presa 60 ton dhe tranxha universale, me pjesë elektrike nga pala turke të cilat do të montohen nga pala shqiptare.

b. Reparti i fonderisë dhe kovaçana

Dy çekiçët pneumatike do të kompletohen me pajisje elektrike nga pala turke, ndërsa montimi do të bëhet nga pala shqiptare.

c. Reparti i skafit i KS-ve (6A):

Për tranxhën, nga pala turke do të sigurohen pajisjet elektrike ndërsa montimi do të kryhet nga pala shqiptare.

d. Reparti i Dizel-Gjeneratorit 500 Kw:

Pala turke merr përsipër të sjellë dhe të montojë dizel-gjeneratorin dhe pajisjet elektrike të nevojshme brenda tij. Pala shqiptare merr përsipër të sigurojë montimin e linjës së jashtme nga reparti i dizel gjeneratorit deri tek konsumatorët.

e. Përveç makinerive të përcaktuara në pikat a,b, c nëpër reparte do të vihen në gatishmëri edhe vinçat urë. Makineritë e tjera, të cilat nuk janë të cilësuar në këtë shtesë protokolli, do të hiqen nga reparte përkatëse dhe do të grumbullohen në një magazinë, duke u parë mundësia nga të dy palët, për rivënien në gatishmëri të ndonjë makinerie të veçantë.

f. Për shkallën e nxjerrjes së anijeve:

Gjatë punimeve në repartet e mësipërme në përputhje me dëshirën e të dy palëve, do të studiohet dhe të vlerësohet mundësia e riparimit të shkallës së nxjerrjes së anijeve.

Teksti dhe nënshkrimi

a. Ky protokoll për të qënë i zbatueshëm përgatitet në gjuhën shqipe, turke dhe angleze në dy kopje. Në rast se do të ketë paqartësira në njërën nga gjuhët do të merret si bazë gjuha angleze.

b. Ky agriment bëhet në dublikate, në.... (data) e Muajit të ... vitit dhe në nënshkruhen në prezencë klauzolat e mësipërme në datë

Në emër të Republikës së Shqipërisë
Turqisë

Ministria e Mbrojtjes

Nënshkrimi

Emri: Kap.Rang.I Robert Bali

Titulli: Albanian CNO

Në emër të Republikës së

Shtabit të Përgjithshëm

Nënshkrimi

Emri. Adm Salim Dervisoglu

Titulli: Turkish CNO

SHTESË-PROTOKOLL NDËRMJET SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS
TURKE DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË RRETH
VEPRIMTARIVE TË NJËSISË LOGJISTIKE TURKE ME ELEMENTET E RUAJTJES,
MIRËMBAJTJES DHE SIGURIMIT

Shtabi i Përgjithshëm i Republikës Turke dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë (këtej e tutje të referuara si “Palë”)

Duke marrë në konsideratë kushtet në:

“Marrëveshjen për Bashkëpunimin në Fushat Ushtarake të Stërvitjes, Teknikës dhe Shkencës ndërmjet Qeverisë së Republikës Turke dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë”, nënshkruar më datë 29 korrik 1992,

“Marrëveshjen rreth Bashkëpunimit Teknik dhe Industrisë së Mbrojtjes” ndërmjet Qeverisë së Republikës Turke dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, nënshkruar më datë 19 nëntor 1992,

“Marrëveshjen e Bashkëpunimit në Stërvitjen Ushtarake” ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më datë 19 nëntor 1992

“Protokollin mbi Asistencën dhe Bashkëpunimin për Forcat e Armatosura” ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Shqipërisë, nënshkruar më 27

qershor 1997,

“Protokollin ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës të Shqipërisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së Kantierit të Pashalimanit dhe ndërtesave të barakave detare, mbështetjes me instruktor konsultativ dhe teknik të instalimeve të pajisjeve të oficinës, për të vendosur në punë dhe për menaxhimin e dokut të nënshkruar më 24 mars 1998,

“Protokollin ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë dhe Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së Ndërtesave të Akademisë Detare Shqiptare, instalimin dhe vendosjen në punë të këtyre ndërtesave për stërvitje, pajisje mësimore, si dhe me mbështetje me instruktor-menaxher-konsulent me mbështetje personeli të konsulentit-instruktor rreth stërvitjes së studentëve shqiptarë të nënshkruar më 24 mars 1998,

Me dëshirën për të çuar më tej miqësinë dhe bashkëpunimin bazuar në respektin reciprok, bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj shtese Protokollit është për të përcaktuar normat e Njesisë Logjistike Turke me Elementet e mirëmbajtjes dhe riparimit të Akademisë Detare Shqiptare, Kantierin e Portit të Pashait dhe ndërtesave të barakave të detarëve në Garnizonin e Pashalimanit, sigurimin e personelit, si dhe sigurimin e të gjitha llojeve të materialeve dhe mjeteve që do të dërgohen në Shqipëri.

Neni 2

Përmbajtja

Ky Protokoll shtesë përfshin:

1. Personelin e Njesisë Logjistike Turke me elemente të riparimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes për kantierin e portit të pashalimanit, ndërtesave të barakave të detarëve në garnizonin e Pashalimanit dhe ndërtesave të Akademisë së Detarisë në Vlorë dhe për sigurimin e personelit dhe të materialeve, që do të përdoren për përmbushjen e të dy Protokoll Marrëveshjeve të nënshkruara më datën 24 mars 1998.

2. Personeli shqiptar, i cili do të ngarkohet për sigurimin e jashtëm, Ministria e Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë.

Neni 3

Përkufizime

1. “Personel i autorizuar” nënkupton Komandantin e Njesisë Logjistike Turke me elemente ruajtje për anën turke dhe komandantin e njesisë shqiptare të sigurimit për anën shqiptare.

2. “Veprimtaria” nënkupton të gjitha llojet e veprimtarive ndërtimore, riparuese/mirëmbajtëse në Shqipëri, të përmendura në nenin 1.

3. “Njësia Logjistike Turke me elementet e riparimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes” nënkupton një personel të përbërë prej 200 persona, përgjegjës për sigurimin e brendshëm të ndërtimeve, veprimtarive të riparimit dhe mirëmbajtjes dhe për sigurimin e të gjitha llojeve të materialeve dhe të personelit në Shqipëri me këtë qëllim.

4. “Njësia Shqiptare e Sigurimit” nënkupton njësinë e cila do të parashikojë sigurimin e jashtëm për Njësinë Logjistike Turke me elemente riparimi, mirëmbajtjeje dhe ruajtjeje.

5. Për përkufizimet të cilat nuk janë përcaktuar në këtë protokoll, do të merren si bazë përkufizimet në protokollin dhe marrëveshjet e tjera.

Neni 4

Parimet e përgjithshme dhe detyrimet

1. Pala shqiptare do të marrë masa për të realizuar transferim të sigurtë dhe të shpejtë të Njesisë Logjistike Turke me elemente të saj siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 3 në zonat e detyrës pas mbërritjes në Shqipëri.

2. Pala Shqiptare do të sigurojë asistencën e nevojshme për Njësine Logjistike Turke me elementet e saj të përcaktuara në nenin 3, paragrafi 3, për sigurimin normal të veprimtarisë.

3. Personeli i autorizuar i të dy palëve do të përgatiti një protokoll zbatimi, në të cilin do të zënë vend parimet bazë të përgjegjësisë dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

4. Pala Shqiptare do të ndihmojë Palën Turke për kërkesat logjistike që nevojiten për t'u dhënë nga burimet lokale dhe të luajnë një rol ndërmjetës tek to.

5. Personeli i Njesisë Logjistike Turke me elementët e saj të përcaktuara në nenin 3, paragrafi 3, do të përdorë ekzaminimet mjekësore dhe mjetet (pajisjet) trajtuese pa pagesë të siguruara tek ekuivalentet e tyre në Shqipëri.

6. Hyrja dhe largimi i personelit të Palës Turke në/nga shqipëria do të sigurohet me një dokument hyrjeje dhe leje qëndrimi, i cili do të ketë fotografinë e poseduesit dhe vulën e autoriteteve përgjegjëse shqiptare të përgatitura në përputhje me legjislacionin e brendshëm shqiptar.

Emrat dhe informacioni i identifikimit të personelit që vjen në grup ose vetëm në Shqipëri do të listohen dhe do t'i dorëzohen Këshillit të Koordinimit dhe Bashkëpunimit të Forcave Ushtarake Turke në Tiranë një javë përpara datës së mbërritjes, për t'ia dhënë Autoriteteve Përgjegjëse shqiptare me qëllim për të siguruar një klirance me lehtësira doganore dhe pa vonesa.

7. Të gjitha llojet e materialeve që do të merren ose do të nxirren nga Shqipëria nëpërmjet Njesisë Logjistike Turke do të jenë pa pagesë përsa i përket taksave dhe detyrimeve doganore. Listat e materialeve do t'u jepen autoriteteve shqiptare një javë përpara datës së hyrjes/largimit dhe pasi të sigurohet që më parë përfundimi i procedurave të lejimit për hyrje/largim, do të sigurohet kalimi përgjatë doganave pa vonesë.

8. Për çështjet të cilat nuk mbulohen në këtë Shtesë Protokolli, Klauzolat e Marrëveshjeve, Protokolleve të përmendura në parathënie e kësaj Shtese Protokolli do të jenë të vlefshme.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve fillimisht do të bëhet ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, nëse nuk ka zgjidhje, do të përdoren kanalet diplomatike.

Neni 6

Ndryshimi dhe rishikimi

Çdo palë mund të propozojë me shkrim një ndryshim ose rishikim të kësaj shtese protokolli. Në këtë rast, palët do të fillojnë konsultimet brenda 30 ditëve.

Neni 7

Zgjatja kohore

Kjo shtesë protokolli është e vlefshme për atë kohë sa Njësia Logjistike Turke me elementet e përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 do të kryejë veprimtarinë në Republikën e

Shqipërisë për realizimin e Protokoll Marrëveshjeve të nënshkrura më datë 24 mars 1998. Pas tërheqjes së Njësisë Logjistike Turke, kjo shtesë protokolli dhe protokollet e tjera në lidhje me të, do të përfundojnë automatikisht.

Neni 8

Ratifikimet dhe hyrja në fuqi

Kjo shtesë protokolli do të ketë efekt pas nënshkrimit dhe në datën e shkëmbimit të notave diplomatike duke e ratifikuar në lidhje me procedurat ligjore respektive.

Neni 9

Teksti dhe nënshkrimi

Kjo shtesë protokolli bëhet në dy kopje, në gjuhën turke, shqiptare dhe angleze, duke qenë të gjithë tekstet autëknik. Në rast ndryshimesh thelbësore midis teksteve në këto gjuhë, teksti në anglisht do të jetë prioritar.

Për Ministrinë e Mbrojtjes
së Republikës të Shqipërisë

Për Shtabin e Përgjithshëm
së Republikës të Turqisë

Nënshkrimi
Emri: Kap.RangI Robert Bali
Titulli: Komandant i Flotës Shqiptare

Nënshkrimi
Emri:Adm Salim Dervisoglu
Titulli: Komandant i Flotës Turke